



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Dr. Fidelma Donlon, Administratore

Data: 18 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

'Parashtrimi të Administratores në përputhje me rregullën 23(2) mbi masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19', parashtrimi F00063 i datës 8 nëntor 2020

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses të Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Në përputhje me rregullën 23(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja')¹, Administratorja i paraqet Gjykatësit të Procedurës Paraprake parashtrime mbi masat për zbutjen e rrezikut nga koronavirusi ('KOVID-19') gjatë zhvillimit të procedurave që kanë të bëjnë me z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup KRASNIQI (bashkërisht, 'të akuzuarit').

II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendimi') që miratoi kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS') për arrestimin dhe transferimin e të akuzuarve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ('objekti i paraburgimit') në Holandë ('shteti pritës').²

3. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, ZPS-ja arrestoi të akuzuarit në Kosovë.³ Pas zbatimit të urdhrave për transferim, të akuzuarit u pranuan në objektin e paraburgimit më 4 dhe 5 nëntor 2020.⁴

¹ Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020 ('Rregullorja').

² Vendimi mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhrat për transferim, KSC-BC-2018-01/F00128, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ Njoftimi i arrestimit të Hashim Thaçit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-06/F0051, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; Njoftimi i arrestimit të Kadri Veselit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-06/F0050, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Njoftimi i arrestimit të Rexhep Selimit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-06/F0049, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Njoftimi i arrestimit të Jakup Krasniqit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-06/F0044, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ Njoftimi i pranimit të Hashim Thaçit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi emërimin e mbrojtësit, KSC-BC-2020-06/F00053, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Njoftimi i pranimit të Kadri Veselit objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi emërimin e mbrojtësit, KSC-BC-2020-06/F00054, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; Njoftimi i pranimit të Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-06/F00055, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Njoftimi i pranimit të Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-06/F00048, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

III. DISKUTIM

4. Parashtrimi përfshin informacion në lidhje me masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19: (a) në Holandë ('shteti pritës'), me fokus të posaçëm në kufizimet e udhëtimit dhe masat për vetëkarantinë; (b) në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ('objekti i paraburgimit'), duke përfshirë edhe kohën gjatë transportimit për në mjediset e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('mjediset') në Raamweg 47 dhe anasjelltas; dhe (c) në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara ('salla e gjyqit').

A. SHETI PRITËS

5. Qeveria e shtetit pritës ka vendosur masa të përkohshme për shtrëngimin e mbylljes së pjeshme në shtetin pritës duke filluar nga ora 22:00 më 4 nëntor deri më 18 nëntor 2020.

6. Rregullat themelore që vlejnë për të gjithë në shtetin pritës janë: qëndroni në shtëpi sa më shumë që është e mundur dhe shmangni udhëtimet që nuk janë të domosdoshme brenda shtetit pritës; testohuni nëse keni simptoma të KOVID-19; punoni nga shtëpia përveç nëse nuk keni opsion tjetër; mbani maskë në fytyrë në ambiente të brendshme publike dhe në transportin publik nëse jeni të moshës mbi 13 vjeç; mbani distancë 1.5 metra nga njerëzit e tjerë dhe zbatoni masat higjienike themelore, siç është larja e rregullt e duarve.⁵

7. Gjithashtu, janë të ndaluara tubimet me më shumë se 30 njerëz në hapësira të mëvetësishme, me disa përjashtime, duke përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare që janë palë në traktatet me shtetin pritës.⁶

⁵ *Shih* Ministry of Foreign Affairs, Protocol Department, Note Verbale, DPG-Min-BuZa.2020.5891-28, 5 nëntor 2020; *shih gjithashtu* Government of the Netherlands, "Coronavirus COVID-19", <https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020); Haaglanden Veilig, "Actuele informatie maatregelen" (në holandishte), <https://haaglandenveilig.nl/actuele-informatie-maatregelen> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020).

⁶ *Shih* Veiligheidsregio Haaglanden, "Noodverordening COVID-19 veiligheidsregio Haaglanden 4 November 2020" (në holandishte), art. 2.1, *available at*

1. Kufizimet e udhëtimit për udhëtarët nga Kosova

8. Në përgjithësi, qeveria e shtetit pritës këshillon fuqishëm që të mos udhëtoni në shtetin pritës përveçse kur është absolutisht e domosdoshme.⁷
9. Shteti pritës ka vendosur disa kufizime për udhëtarët që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Evropian ('BE'). Aktualisht, shteti pritës dhe vendet e tjera të BE-së dhe Shengenit, si dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore ('MB'), i kanë mbyllur kufijtë e jashtëm për njerëzit udhëtimi i të cilëve nuk është i domosdoshëm, me disa përjashtime.
10. Ndalimi i udhëtimit nuk zbatohet ndër të tjerë për personat të cilët punojnë për organizatat ndërkombëtare.⁸ [REDAKTUAR].

2. Karantina për udhëtarët nga Kosova

11. Me të mbërritur në shtetin pritës, udhëtarët nga vendet jashtë BE-së, përfshirë ata që vijnë nga Kosova, duhet të hyjnë në vetëkarantinë për 10 ditë.⁹ Kjo vlen madje edhe për personat që nuk kanë simptoma, si dhe për personat që janë testuar negativ për KOVID-19, përpara ose menjëherë pas mbërritjes në Holandë.¹⁰
12. [REDAKTUAR].
13. [REDAKTUAR].
14. [REDAKTUAR].

<https://haaglandenveilig.nl/sites/default/files/2020-11/Noodverordering%204%20november%20definitief.pdf>.

⁷ *Shih* Government of the Netherlands, "Traveling to the Netherlands from Abroad", <https://www.government.nl/topics/coronavirus-kovid-19/tackling-new-coronavirus-in-the-netherlands/travel-and-holidays/visiting-the-netherlands> (e vizituar për herë të fundit më 8 nëntor 2020).

⁸ *Shih* [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu* Rijksoverheid, "Naar Nederland reizen: Ik ben een zakenreiziger" (në holandishte), <https://www.rijksoverheid.nl/onderwerpen/coronavirus-kovid-19/reizen-en-op-vakantie-gaan/buitenlandse-toeristen-naar-nederland> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020).

⁹ Për këshilla udhëtimi në lidhje me Kosovën, shih faqen e internetit të Koninkrijk der Nederlanden, "Reisadvies Kosovo" (në holandishte), <https://www.nederlandwereldwijd.nl/landen/kosovo/reizen/reisadvies> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020).

¹⁰ *Shih* Government of the Netherlands, "Self-Quarantine upon arrival in the Netherlands/ Vetëkarantina me të arritur në Holandë", <https://www.government.nl/topics/coronavirus-kovid-19/tackling-new-coronavirus-in-the-netherlands/travel-and-holidays/self-quarantine> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020).

3. Largimi i përkohshëm nga vetëkarantina

15. Nëse është absolutisht e domosdoshme, udhëtarë të tjerë gjithashtu lejohen të largohen nga vetëkarantina dhjetëditëshe për disa qëllime, nëse nuk kanë simptoma të KOVID-19. Për shembull, udhëtarët mund të largohen nga vetëkarantina për punë të domosdoshme për organizatat ndërkombëtare të caktuara, siç janë Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.¹¹ Përveçse për këtë qëllim specifik, udhëtarët duhet t'u binden rregullave për vetëkarantinë. Për shembull, ata nuk duhet të përdorin transportin publik dhe duhet t'u shmangen kontakteve sociale.

B. OBJEKTI I PARABURGIMIT

16. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit e këshillon rregullisht Administratoren dhe shefin e paraburgimit në lidhje me masat e shëndetit publik në objektin e paraburgimit.

17. Objekti i paraburgimit gjendet në [REDAKTUAR] të burgut të shtetit pritës, PI Haaglanden ('Burgu'). [REDAKTUAR].

1. Masat e shëndetit publik

18. Që nga shpërthimi i pandemisë, mjeku i Njesisë së Paraburgimit¹² i ka dhënë vazhdimisht këshilla [REDAKTUAR] për të ruajtur dhe promovuar shëndetin e të paraburgosurve gjatë pandemisë. [REDAKTUAR].¹³

19. [REDAKTUAR].

20. [REDAKTUAR].

¹¹ *Shih* Government of the Netherlands, "When you don't have to self-quarantine (stay at home)/ Kur nuk duhet të hyni në vetëkarantinë (të rrini në shtëpi)", <https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tackling-new-coronavirus-in-the-netherlands/travel-and-holidays/when-you-dont-have-to-self-quarantine> (e vizituar për herë të fundit më 6 nëntor 2020).

¹² Në rregullën 2.2 të Rregullores së Paraburgimit, "Mjeku i Njesisë së Paraburgimit" përkufizohet si: "Mjeku përgjegjës për trajtimin mjekësor në objektin e paraburgimit, zëvendësi i tij ose i saj, ose cilido mjek tjetër i emëruar nga autoritetet kompetente të shtetit pritës për trajtimin mjekësor të një të paraburgosuri".

¹³ Shtojca 1: [REDAKTUAR].

2. Vizitat me të paraburgosur

21. [REDAKTUAR].¹⁴

22. Përdorimi i videolidhjes për vizita me mbrojtësit inkurajohet fuqimisht; sidoqoftë, në objektin e paraburgimit lejohen edhe vizitat personale me mbrojtësit që janë të domosdoshmërisë jetike.

23. Për të mbrojtur shëndetin e të paraburgosurve dhe të tjerëve në objektin e paraburgimit, nuk lejohen më shumë se dy vizitorë të pranishëm në të njëjtën kohë në vizitë me mbrojtësin.¹⁵ Mbrojtësit gjithashtu janë të obliguar t'u përgjigjen pyetjeve lidhur me shëndetin publik dhe t'i nënshtrohen kontrollit të temperaturës para se të lejohen të hyjnë në objektin e paraburgimit.¹⁶ Për më tepër, mbrojtësit janë të obliguar të mbajnë pajisje mbrojtëse personale ('PMP') kur janë brenda objektit të paraburgimit, përfshirë kohën gjatë vizitave, të dezinfektojnë duart dhe t'u përmbahen masave të tjera higjienike, dhe të mbajnë distancë fizike të caktuar me të paraburgosurit dhe të tjerët.

24. Me këshillë të mjekut të Njësisë së Paraburgimit, Administratorja i ka kufizuar përkohësisht vizitat personale me anëtarë të familjes dhe vizitorë të tjerë personalë në objektin e paraburgimit. Në vend të vizitave personale, Administratorja ka autorizuar vizitat përmes videolidhjes me të afërmit e ngushtë të të paraburgosurve.¹⁷

3. Transportimi në seanca gjyqësore dhe anasjelltas

25. Në mënyrë që të kufizohen kontaktet e jashtme, transportimi i jashtëm i të paraburgosurve kryhet vetëm në rrethana të posaçme dhe urgjente. Në rrethana të tilla, shërbimi i transportit i Shërbimit të Burgjeve të Shtetit Pritës ('DV&O') ka

¹⁴ [REDAKTUAR].

¹⁵ *Shih* Udhëzimi i Zyrës Administrative për kufizimet e përgjithshme mbi vizitat për shkak të COVID-19, KSC-BD-35, 23 shtator 2020, pjesa. 5.1.

¹⁶ *Shih* Udhëzimi i Njësisë së Paraburgimit mbi kushtet e sigurisë për hyrje në objektin e paraburgimit, KSC-BD-32, 23 shtator 2020, pjesa 11.

¹⁷ Udhëzimi i Zyrës Administrative për kufizimet e përgjithshme mbi vizitat për shkak të COVID-19, KSC-BD-35, 23 shtator 2020; Udhëzimi i Zyrës Administrative për vizitat përmes videolidhjes, KSC-BD-34, 23 shtator 2020.

vendosur masa parandaluese për transportimin e të paraburgosurve në seanca gjyqësore dhe anasjelltas që janë në përputhje me masat e shtetit pritës.

26. [REDAKTUAR].

C. SALLA E GJYQIT

27. Në mjediset në Raamweg 47, masat për zbutjen e rrezikut janë në përputhje me masat e shtetit pritës. Për shembull, niveli i pranisë së njerëzve në ndërtesë është kufizuar për të mundësuar distancimin fizik, dhe hapësirat e përbashkëta siç janë hyrjet për personelin dhe publikun, gjithashtu janë konfiguruar për të respektuar parimin e distancimit prej 1.5 metrash. Gjithashtu, në të gjitha mjediset mund të shihen qartë udhëzimet për vendkalimet dhe pikat e pastrimit të duarve, si edhe udhëzimet për pastrim dhe pikat për pastrim në hapësirat e përbashkëta. Mbjajtja e maskave të fytyrës është e obligueshme për të gjithë punonjësit kur largohen prej bankës së punës, kur kalojnë nëpër ndërtesë dhe në mjediset e përbashkëta.

28. Në aspektin e zbutjes së rrezikut, salla e gjyqit dhe objekti i paraburgimit kanë mjete teknike për të siguruar dy transmetime të njëkohshme të mbrojtura të videokonferencave në sallën e gjyqit. Masat për zbutjen e rrezikut në sallën e gjyqit gjithashtu janë në përputhje me masat e shtetit pritës. Ato përfshijnë masat e higjienës themelore, siç është pastrimi i duarve para hyrjes dhe daljes dhe pastrimi i pajisjeve dhe orendive para fillimit të çdo seance dhe gjatë çdo pauze midis dy çështjeve.

29. Ulëset në sallën e gjyqit gjithashtu janë konfiguruar për mbajtjen e distancës fizike prej 1.5 metrash, së bashku me instalimin e mburojave prej xhami. Nëse personat në sallën e gjyqit nuk janë në gjendje të mbajnë distancën prej 1.5 metrash (për shembull, kur këshillohen mes vete), duhet të mbahen maskat jomjekësore të fytyrës.

30. Nuk ka nevojë për modifikime të bankës së gjykatësve për seanca me Gjykatësin e Procedurës Paraprake. Po ashtu, kabinat e përkthyesve me gojë janë mjaftueshëm të gjera për mbajtjen e distancës fizike të nevojshme. Në qelitë e pritjes në Raamweg 47, është vendosur ndarje prej xhami në dhomën e vizitave të mbrojtësve.

31. Galeria publike është rikonfiguruar për të lejuar më së shumti deri në 20 vizitorë në ulëse dhe një karrocë invalidi. Gjithashtu, hapësira për shtypin është konfiguruar për të mbajtur më së shumti deri në 14 persona në sallën e informimit të shtypit dhe deri në 6 persona të tjerë në tryezat e punës në qendrën e medias.

32. Vizitorët në ndërtesë, përfshirë edhe mediat, duhet të regjistrohen paraprakisht dhe do t'u kërkohet që t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me shëndetin publik, para se të lejohen që të hyjnë në ndërtesë.

33. Në hyrjen publike të sallës së gjyqit, mjediset e regjistrimit dhe pritjes, galerinë publike dhe në mjediset e shtypit, distanca prej 1.5 metrash dhe mbajtja e maskave jomjekësore të fytyrës janë të obligueshme tërë kohën.

D. KLASIFIKIMI

34. Ky parashtrim dhe shtojca e tij janë protokolluar konfidencialisht në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, meqë përmbajnë të dhëna personale shëndetësore dhe të dhëna në lidhje me procedurat e Zyrës Administrative dhe informacion në lidhje me konsultimet dhe komunikimet me palë të jashtme, të cilat bartin pritshmëri të arsyeshme për respektimin e privatësisë dhe mosnxjerrje të informacionit.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1838

_____/nënshkrim/

Dr. Fidelma Donlon

Administratore

E mërkurë, 18 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë